



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.06.2023

**MBLEDHJA Nr. 31,  
Datë 19.06.2023, ora 13:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 19.06.2023, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 31 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 06.06.2023
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Maj 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” shpk për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi pezullimin e zbatimit të afatit të parashikuar në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s 343, datë 21.12.2022
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARI I BORDIT**  
**Erjola SADUSHI**